



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3448/prot.
16

Pogradec, më 30 .08 .2024

VENDIM

NR 90, DATË 29 .08 .2024

**“PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA
ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOPËSHTE DHE SHKOLLA NË
BASHKINË POGRADEC ”**

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në Ligjin Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.85, datë 11.08.2023" si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative përkatëse,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Të rinovohen kontratat e lidhura në vitin 2023 nga Bashkia Pogradec për ambientet e marra me qera në kuadër të funksionimit të tyre si objekte që kanë shërbyer si kopshte dhe çerdhe.
2. Rinovimi i këtyre kontratave të hyjë në fuqi më datë 01.09.2024, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2024-2025 dhe do të zgjasë deri më 01.07.2025.
3. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si mëposhtë:
 - 3.1 Fshati Selcë e Poshtme në Njësinë Administrative Proptisht. Ambjenti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023 me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.



[Signature]

- 3.2 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si kopësht dhe si shkollë (arsim fillor), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 3.3 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si shkollë (arsim fillor), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 3.4 Fshati **Stropckë** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambjenti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.
4. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 24 vota

2.Vota Pro 29

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.08.2024